



Mural Fest Kosova

Plani Strategjik

6 Janar 2020

Përgatitur nga Fortunë Haziri

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| Akronimet | iv |
| 1 Hyrje | 1 |
| 1.1 Organizata | 1 |
| 1.2 Objektivat e procesit të planifikimit strategjik | 1 |
| 1.3 Metodologjia | 1 |
| 2 Profili i organizatës | 2 |
| 2.1 Historia | 2 |
| 2.2 Vizioni | 2 |
| 2.3 Misioni | 2 |
| 2.4 Vlerat | 2 |
| 2.5 Qasja e tanishme | 3 |
| 2.6 Sfidat e tanishme | 3 |
| 3 Konteksti i veprimit të organizatës | 4 |
| 3.1 Ambienti | 4 |
| 3.2 Resurset | 4 |
| 3.3 Palët e interesuara | 4 |
| 3.4 Mundësite dhe rreziqet | 5 |
| 4 Plani | 5 |
| 4.1 Indikatorët kyç | 5 |
| 4.2 Grupet e targetuara | 6 |
| 4.3 Rajoni i targetuar | 6 |
| 4.4 Qasja strategjike | 6 |

Akronimet

| | |
|------|--|
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| DKRS | Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| OJQ | Organizatë joqeveritare |
| TK | Trashëgimia Kulturore |
| MF | Mural Fest |

1 Hyrje

1.1 Organizata

Organizata Jo-Qeveritare Mural Fest Kosova u themelua gjatë vitit 2016 dhe fushëveprimi ynë është:

- Mbështetja e projekteve kulturore në Kosovë,
- Promovimi dhe zhvillimi i fushës së artit rrugor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar,
- Fuqizimit të artistëve të rinj në Kosovë,
- Edukimi dhe vetdijësimi i qytetarëve rreth rëndësisë së artit
- Artvizmi

1.2 Objektivat e procesit të planifikimit strategjik

Objektivat e procesit të planifikimit strategjik janë:

- Zhvillimi dhe promovimi i Mural Fest
- Rritja e kapaciteteve të të rinjve në fushën e artit dhe aktivizmit
- Ngritja e vetdijes së qytetarëve rreth dukurive negative
- Zhvillimi i artit në vend
- Shndërrimi i qytetit të Ferizajt në qytet të muraleve
- Promovimi i turizmit kulturor
- Krijimi i vendeve të punës në fushën e artit
- Realizime të marrëveshjeve për bashkëpunim me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar,
- Zhvillimin e kuadrove të reja profesionale në fushën e Artit dhe Kulturës,

1.3 Metodologjia

Ky plan strategjik është përpiluar në këshillim të vazhdueshëm me Bordin Drejtues dhe stafin e Mural Fest. Përderisa fushëveprimi i organizatës sonë është mbi kulturën dhe artin, janë mbledhur informacione rreth nevojave dhe problematikave që paraqiten në këtë fushë në Kosovë, për të cilat MF do të angazhohet në vazhdimësi t'i trajtojë përmes projekteve të ndryshme.

2 Profili i organizatës

2.1 Historia

Festivali i muraleve ka lindur si rrjedhojë e aktiviteteve të vazhdueshme që kanë të bëjnë po me këtë fushë, pra me muralet. Muralet në qytetin e Ferizajt janë bërë në vazhdimësi duke filluar nga viti 1967 me “Kamarieri” i vendosur në ballinën e Hotel Luboten, pastaj 2004 si mural i dyti në qytet . Mandej murali tjetër vjen me temën “Bashkimi familjar”, mural ky i realizuar nga artistet gra në vitin 2014.

Në vitin 2016 artistet e qytetit me iniciativën e Shoqatës Artistike “Zef Kolombi” filluan një sërë aktiviteteve artistike në formë “street art” ku disa të rinjë të qytetit realizuan grafito e murale në hapësira të ndryshme. Dhe qytetit tonë ju shtuan një numër i konsiderueshëm me punime si: trafoja e vjetër e shndërruar në pikturë; murali “ Toleranca ndërfetare” etj. Krejt kjo është si rrjedhojë e një iniciative më të madhe që do të kurorëzonte punën e artisteve Ferizajas duke vendosur për një Festival më të madh, njëherësh ndërkombëtare, pra Festivalin e Muraleve MURALFEST.

Duke synuar në promovimin e komunitetit artistik në Ferizaj, fuqizimin dhe mbështetjen e tyre, si dhe organizimin e Festivalit të muraleve dhe bazuar në të drejtën tonë për liri të asociimit të garantuar me nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Liri të Asociimit në OJQ 04/L-57, ne – të poshtëshënuarit – me vullnet të lirë vendosim që të themelojmë Festivalin e Muraleve “MURAL FEST”, i cili mund të njihet edhe me shkurtesën zyrtare “MURAL FEST”. Themeluesit e organizatës janë:

– Lebibe Topalli – Shabani – Piktore,

– Pranvera Sylejmani – Piktore,

– Antigona Heta – Piktore.

Aktivitetet themelor i organizatës është promovimi i artit pamor dhe promovimi i jetës kulturore në qytetin e Ferizajt dhe më gjerë.

Qëllimet tjera të organizatës janë:

- Promovimi, zhvillimi e Festivalit të Muraleve,
- Aktivizimi i femrës artiste në qytet,
- Fuqizimi e artisteve të rinj në qytetin e Ferizajt,
- Edukimi estetik dhe ngritja e interesimit të qytetarëve mbi artin.

Sot këshilli organizativ përbëhet prej anëtarëve të fushave të ndryshme si: piktor, dizajner, regjisor, gazetarë, anëtar nga shoqëria civile, krejt kjo me qëllim për një profesionalizëm më të denjë.

2.2 Vizioni

Mural Fest synon që të jetë festival i qendrueshëm, ndërkombëtar, e që në një të ardhme të afërt Ferizaj të identifikohet si qytet i muraleve.

2.3 Misioni

Misioni i Mural Fest është që të promovojë artin dhe kulturën në vend, duke shfytëzuar artin si mjet vetëdijësues për shoqërinë.

2.4 Vlerat

Vlerat thelbërsore të “Mural Fest” janë:

- Promovimi i Artit
- Avancimi i të rinjve në Art,
- Edukimi dhe studimi i artit dhe fushave të artit,
- Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore,
- Profesionalizmi,
- Avokimi,
- Turizmi.

2.5 Qasja e tanishme

Mural Fest aplikon në thirrjet e ndryshme të hapura kombëtare dhe ndërkombëtare. Si donator potencial prej në fillim ka patur komunën e Ferizajit, gjegjësisht DKRS Ferizaj, më tej MKRS, Us Embassy, Sëiss Embassy e shumë biznese lokale, të cilët secili në mënyrën e vetë e ka përkrahur zhvillimin e Mural Fest. Këtë vit përgjigje pozitive për përkrahje ka dhënë komuna e Prishtinës me projektin “Beautiful Prishtina” ,

2.6 Sfidat e tanishme

Natyrisht, si organizatë e posakrijuar kemi edhe disa sfida të cilat besojmë se do t'i tejkalojmë së shpejti. Ndër to më kryesoret janë: mungesa e një depoje për materiale të punës, mungesa e infrastrukturës dhe mjeteve të punës, mungesa e fondeve të mjaftueshme, qasja në institucione sidomos ne posedimin e lejeve te hapësirave publike, mjetet e materialet specifike e te kushtueshme per organizimin e festivalit etj.

3 Konteksti i veprimit të organizatës

3.1 Ambienti

Mural Fest tanime posedon dy zyre me sipërfaqe prej 80m², njëra për ceshtje administrative dhe tjetra për aktivite të rinjve. E domosdoshme dhe e nevojshme për funksionimin e Mural fest do të ishte një hapësisë-depo për ruajtjen e materialeve: ngjyra, brusha, shtafellaja, shkallë etj.

3.2 Resurset

Resurset kryesore mbi të cilat mbështetet Festivali janë kuadrot profesionale. Shumica e kuadrove tona profesionale janë të shkolluar brenda por edhe jashtë vendit, kanë bagazh të fortë profesional dhe përvojë të gjatë profesionale. Po ashtu, kuadrot tona vijnë nga fusha të ndryshme, si: piktura, arkitektura, arkeologjia, regjia, gazetaria, menaxhim të financave, muzikë etj

Organizata jonë vështirësi në marrjen e fondeve ka patur sidomos në vitin e parë të themelimit të saj, në vitin 2016, kur ka funksionuar vetëm me përkrahjen e komunes lokale dhe disa bizneseve. Rezultati i punës së këtij edicioni ka bërë që vitin e dytë festivalin ta përkrahin edhe donatore të tjera e edhe Us Embassy, Fiq, ndërsa vitet e ardhshme do të ishin edhe me të lehtë mbështetjes nga donatorët, organizatat e edhe ambasadat e huaja si Sëiss Embassy, European Union, Us Embassy etj.

Tashmë kemi përfituar projekte ndërkombëtare dhe kredibiliteti i emrit, të organizatës sonë do të forcohet.

3.3 Palët e interesuara

Deri më tash, kemi arritur të mobilizojmë studentët dhe nxënësit nga fusha e artit dhe kulturës Mural Fest si fokus të veçantë ka bashkëpunimin me shkollën e mesme të artit “Çesk Zadeja” në Ferizaj me ç’rast pothuajse të gjitha aktivitetet e orgaizates lidhen direkt me interesat e këtyre nxënësve. Këta të rinj, të cilët janë duke punuar në baza vullnetare do të bëhen edhe baza e zgjerimit të mëturjes së profesional.

Përveç institucioneve relevante, palë të interesuara mund të jenë edhe profesionistët e fushës së artit, profesionistët e pavarur, artistët ndërkombëtarë, dashamirësit dhe vullnetarët të cilët kanë interes në përmirësimin e gjendjes së artit dhe kulturës.

3.4 Mundësitë dhe rreziqet

Organizata jonë ka mundësi të mira të bashkëpunimit me institucion lokale dhe qendrore ne veqanti me drejtorine e urbanizmit ketu ne Ferizaj. Punimet qe implementon Mural Fest jane kryesisht punime artistike por ne hapësira publike, dhe kjo eshte arsyeja qe Mural Fest eshte e mvarun direkt ne institucionet lokale e qendrore, por qe njëkohësisht paraqitet edhe rreziku qe këto palë nuk janë të interesuara të bashkëpunojnë me ne ne te ardhmen..

4 Plani

4.1 Indikatorët kyç

Arritja e këtyre objektivave do të matet pas raporteve që ka për detyrë të dorëzojë Drejtoresha Ekzekutive duke ndjekur indikatorët kyç:

- Angazhimi i stafit
- Afatet kohore
- Realizimi i plotë buxhetor
- Efiqienca

4.2 Grupet e targetuara

Target grupet që Mural Fest planifikon të punojë janë:

- Të rinjtë nga mosha 14-27 vjeç nga Kosova
- Minoritetet
- Profesionistë të rinj në fushën e artit
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtoritë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të komunave të ndryshme të Kosovës,
- Rrjetet e organizatave ndërkombëtarë që veprojnë në fushën e artit

4.3 Rajoni i targetuar

Mural Fest ka për qëllim që të shtrihet në gjithë territorin e Kosovës, por që gjatë vitit 2021 do të koncentrohemi në regjionet e Ferizajt, Prizrenit, Gjilanit e Prishtinës. Në vitet e ardhshme do shohim mundësinë që të gjejmë bashkëpunëtorë edhe në qendrat tjera.

4.4 Qasja strategjike

Për realizimin e projekteve në fushën e artit, ekipi i Mural Fest do të aplikojë në thirrjet e hapura nga institucione lokale e qendrore si dhe organizata të ndryshme.

Pos aplikimit në thirrje të hapura, do të përpilohen projekt-propozime të cilat do ju paraqiten donatorëve të mundshëm.

Ekipi i MF duhet të koncentrohet në krijimin e kontakteve dhe rrjetit profesional për bashkëpunime të mëtutjeshme me institucione, organizata, ambasada apo individë.

Meqenëse stafi i MF është kryesisht nga artistë, synohet që të rritet dhe zhvillohen kapacitetet e tyre përmes sigurimit të trajnimeve të ndryshme për ta në fushën e menaxhimit të projekteve, financa, aktivizmit etj.

4.5 Programi / aktivitetet

Synimi kryesor për vitin 2021 është zgjerimi i grupit informal Artivistat -permanent te Mural Fest si pjese kryesore e programit te aktiviteteteve qe do te zhvillon Mural Fest. Synim tjetër për vitin 2021 është vazhdimi i punimit të muraleve e grafitëve në nënkalinin e ri te qytetit, si dhe realizimin e skulpturave tjera moderne ne vend.

Gjatë këtyre 5 viteve MF do të angazhohet në zhvillimin e këtyre programeve:

- Festivali i muraleve
- Galeria urbane
- Ringjallja e artit tradicional
- Kampi veror artistik
- Shkolla e artit publik
- Skulpturat moderne ,recikluese dhe kinetike
- Terapia e Artit

Festivali i muraleve - është festivali i përvitshëm i cili mbahet në Ferizaj gjatë muajit shtator. Faza përgaditore fillon muaj më parë ku caktohet tema e cila do të trajtohet gjatë festivalit, pastaj krijohet lista e artistëve pjesëmarrës (vendorë e ndërkombëtarë)

Tema për edicionet propozohet nga ekipi i Mural Fest ne muajin dhjetor dhe miratohet nga bordi ne fund te vitit

Galeria Urbane- krijimi i zonave të caktuara në qytetin e Ferizajt ne vecanti pjesa e nenkalimit ne qytet, sidhe shndërrimin e tyre në galeri urbane. Kjo do të rriste interesimin e vizitorëve dhe do të kontribuonte në zhvillimin e ekonomisë dhe turizmit të qytetit. Kjo tw arrihet pwrmes pwrpilimit tw Strategjisw pwr shndwrrimin e qytetit tw Ferizaj nw Galeri Urbane, ku po e njejta do tw integrohet nw Planin Zhvillimor tw Ferizaj qw starton nga viti 2025, kurse strategjia duhet tw punohwt deri nw 2 vite para.

Ringjallja e artit tradicional - do të fokusohet në sjelljen më afër të artit tradicional tek të rinjtë. Kështu do të ketë aktivitete dhe punëtori që merren me:

- Poçari
- artizanale
- thurrije me shtiza.

Punëtori për poçari - Do të sigurohen mjetet për punë me poçar ku të rinjtë do të trajnohen për poçarë të ardhshëm dhe kështu synojmë të rrisim interesimin për këtë zanat, dhe të krijojmë vende të reja pune.

Kamp artistik planifikohet të mbahet në fshatin Jezerc gjatë muajve prill-maj. Në këtë kamp do të mbledhen të rinjtë të cilët i takojnë moshës 18-25 dhe vinë nga rajoni. Kampi mendohet të zgjasë 1 javë dhe të rinjtë varësisht nga interesi i tyre, do të ndahen në punwtori tw ndryshme, por qw lidhet me zhvillimin e aftwsive tw tw rinjve nw fushwn e artivizmit

Shkolla e artit publik - ky është programi i vetëm i cili do të zhvillohet për gjatë tërë vitit, ku do të organizohen ligjërata dhe punëtori më mentorë vendorë e ndërkombëtarë. Këto aktivitete do të zhvillohen në gjithë Kosovën, për shkak që ka numër të madh të të interesuarve të rinj. Kështu synojmë të nxisim të rinjtë të merren me artivizëm. Ky program do tw pwrgritet tw zhvillohet pwrgrjatw vitit 2024-2025

Skulptura- Duke qene te vetedijshem se ne vendin tone mungon shume arti modern i llojit te skulptures, se si Mural Fest keto vitet e ardhshme rol te vecante do t'i kushtojme kesaj lemie. Ky program do tw lansohet gjatw vitit 2024.

Terapia e Artit -

Kohështrirja e Programeve:

| Programi | 01 | 02 | 03 | 04 | 05 | 06 | 07 | 08 | 09 | 10 | 11 | 12 |
|--------------------------------|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Festivali i muraleve | | | | | x | x | | | | | | |
| Ringjallja e artit tradicional | x | x | | | | | | | | | | x |
| Galeria Urbane | | | x | | | | | | x | x | x | |
| Kamp artistik | | | | x | x | | | | | | | |
| Festivali i muraleve | | | | | | x | x | x | x | | | |

| | | | | | | | | | | | | | |
|----------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkolla e street art | x | x | x | x | x | x | x | x | x | x | x | x | x |
|----------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|